

**UDHËZIM**  
**Nr. 48, datë 27.10.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN**  
**NR. 33, DATË 19.9.2014 "PËR**  
**PROCEDURAT E PRANIMIT, NË**  
**INSTITUCIONET E ARSIMIT TË**  
**LARTË PUBLIK E PRIVAT NË VITIN**  
**AKADEMIK 2014-2015 TË STUDENTËVE**  
**QË TRANSFEROJNË STUDIMET NGA**  
**INSTITUCIONET PRIVATE TË**  
**ARSIMIT TË LARTË TË CILAVE IU**  
**ËSHTË HEQUR LICENCA"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 539, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë",

**UDHËZOJ:**

I. Udhëzimi nr. 33, datë 19.9.2014 "Për procedurat e pranimit, në institucionet e arsimit të lartë publik e privat në vitin akademik 2014-2015 të studentëve që transferojnë studimet nga institucionet private të arsimit të lartë të cilave iu është hequr licenca", të ndryshojë si më poshtë:

1. Pika 8 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"Komisionet e vlerësimit dhe të ekuivalentimit të ngritur pranë IAL-ve publike kryejnë vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve që rezultojnë të rregullta me qëllim ekuivalentimin e rezultateve individuale të secilit prej studentëve ndjekës të programeve përkatëse të studimit në IAL-të private të cilave iu është hequr licenca, deri në orën 12:00 të datës 5 nëntor 2014. Ekuivalentimi individual bëhet duke u bazuar në ekuivalentimin paraprak për çdo program studimi."

2. Pika 10 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"Dekanatet e fakulteteve bazuar në vendimin e komisionit të vlerësimit dhe ekuivalentimit, shpallin, brenda datës 5 nëntor 2014, të dhënat për çdo kandidat, kreditet e ekuivalentuara, detyrimet dhe lëndët e pashlyera, si dhe vitin në të cilin transferohet."

3. Pika 11 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"Në periudhën nga data 5 nëntor 2014 deri në datën 11 nëntor 2014 bëhet regjistrimi i studentëve pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës dhe paguhet tarifa përkatëse. Shuma e derdhur nuk kthehet edhe në rastet kur

kandidati largohet nga programi i studimit."

4. Pika 13 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"IAL-të publike i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së listën e studentëve të regjistruar, brenda datës 19 nëntor 2014, me qëllim pajisjen e tyre me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe të kërkohet nga AKP-ja çregjistrimi i tyre."

5. Pika 1 e kreut VI të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"Kandidatët aplikojnë pranë IAL-ve private nga data 25 shtator deri në datën 7 nëntor 2014."

6. Pika 4 e kreut VI të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"Në IAL-të private aplikantët regjistrohen përfundimisht brenda datës 11 nëntor 2014."

7. Pika 5 e kreut VI të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"IAL-të private i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së brenda datës 19 nëntor 2014, në rrugë postare, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *Excel*, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe do të kërkohet nga AKP-ja çregjistrimi i tyre."

8. Kreu VIII i udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

"AKP pajis studentët, për të cilët IAL-të publike dhe private kanë përcjellë listat me të dhënat përkatëse brenda afateve të parashikuara në këtë udhëzim, me numrin e matrikullimit, dhe ia komunikon atë me shkresë zyrtare IAL-së përkatëse brenda datës 19 dhjetor 2014. Në rastet kur një student nuk mund t'i jepet numri i matrikullimit, AKP-ja i kërkon IAL-së ta çregjistrojë atë. IAL-ja çregjistron studentin brenda 10 ditësh kalendarike nga marrja e kërkesës nga AKP-ja."

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**Lindita Nikolla**

